



| | | | |
|---|---------------------------------------|-------------------------------|---------------------------------|
| Planina / Ditequni Dundheno / Prerodoto Received / Delivery | 07-04-2022 | 2 | viti god year |
| Organi / Dëstria Organ / Dëstria e Org / Unit | IN / Prati IN / Prati Prof. No. | Shtesa Protog. Appendix | Sasia Kolicitimi Quantity |
| SKDMSHCK | 1951/2022 | | 115 |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.155/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca anëtar, me Sabile Avdylin-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.155/2022 të datës 23.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Komuna e Pejës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.ANULOHET vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2021,për ankuesin.

II.OBLIGOHET Kryetari i Komunës që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerrë veprimet e nevojshme me qëllim që të bëhet vlerësimi për vitin 2021 nga eprorët e drejtëpërdrejtë të ankuesit që kanë qenë në vitin 2021.

III.OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Pejës, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Pejës, sipas aktemërimit me numër Nr.01-112-44 të datës 04.01.2012 në pozitën “Shef i Zyrës Ligjore”, në kuadër të Drejtorisë për Administratë. Me datë 31.01.2022, Kryetari i Komunës së Pejës, në mungesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, duke e vlerësuar ankuesin me notën e përgjithshme tre (3).

I pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ankuesi me datën 23.02.2022, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 944/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit vjetor të punës për vitin 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.03.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Pejës. Ndërsa me datën 14.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankuesit, lidhur me shkresat për çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendosjes në lidhje me këtë ankesë, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 944/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit me numër Nr.01-112-44 të datës 04.01.2012 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; të datës 27.09.2012; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin të datës 31.01.2022; Statutin me numër Nr.01/2020 të datës 30.09.2020 të Komunës së Pejës; ID kartelën e ankuesit me numër KPE-0286; Planin e punës për vitin 2021 nga ankuesi; Vendimin me numër Nr.Prot:112/01-46770/2020 të datës 05.06.2020 për emërimin e drejtorit të administratës; Vendimin me numër 01/016/01/130026 të datës 30.11.2021 për zgjedhjen e drejtorit të administratës në pozitën e kryesuesit të kuvendit të komunës së Pejës; Vendimin me numër Nr.Prot:112/01-2521/2022 të datës 10.01.2022 për emërimin e drejtorit të drejtorisë për administratë; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin të datës 27.01.2021; E-mailin zyrtar të datës 31.01.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2022 nga Komuna e Pejës lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2022 lidhur me kërkesën për prova shtesë mbi ankesën e ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2022 lidhur me përgjigjen në kërkesën për prova shtesë nga organi i punësimit; Raportin për periudhën 03.01.2021-31.12.2021 nga ana e zyrës ligjore lidhur me kryerjen e detyrave; Planin e punës për vitin 2021 nga zyra ligjore e Komunës së Pejës; Fletëdorëzimin e datës 11.01.2021 lidhur me planin e punës nga ana e drejtorit të administratës për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2021; Vendimin me numër Nr.Prot:01-016/01-122294 të datës 26.11.2021 për lirimin nga pozita e drejtorit të drejtorisë së administratës në komunën e Pejës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të *kthehet në rivlerësim, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij ka theksuar faktin që formularin e vlerësimit për periudhën janar-dhjetor për vitin 2021, e ka pranuar me datën 09.02.2022, ndërsa nga provat e dërguara nga organi i punësimit/Komuna e Pejës, në formularin e vlerësimit tek pjesa "komentet e të vlerësuarit në rast se është i pakënaqur me vlerësimin e objektivave dhe aftësive", del se ankuesi në këtë vlerësim nuk e ka vendosur nënshkrimin e tij e as datën se kur e ka pranuar të njëjtin, mirëpo i njëjti mban datën 31.01.2022, vetëm sipas dokumentit të gjeneruar nga SIMBNJ. Ndërlidhur me këtë Kolegji konstaton se vlerësimi është bërë në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: "1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshtatimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit" si dhe me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet se: "2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak", e që në rastin konkret, ka qenë e pamundur për Kolegji që të përcaktoj saktë datën se kur është kryer vlerësimi për ankuesin nga ana e Udhëheqësit të tij, kur i është dorëzuar ky vlerësim të njëjtit lidhur me dhënien e komenteve për pajtimin ose mos pajtimin e këtij vlerësimi dhe se kur është nënshkruar i njëjti edhe nga ana e ankuesit, ngase bazuar në dispozitat e lartëcekura afati lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë duhet të bëhet deri me datën 31.01.2022 nga ana e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe i njëjti ti dorëzohet ankuesit, andaj vlerësimi në rastin konkret për ankuesin si i tillë nuk koniderohet se ka përfunduar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë nga ankuesi, ka analizuar paragrafin 2 të nenit 5 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet se: "2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues", rrjedhimisht në kuptim të kësaj dispozite ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokolli 01-016/01-122294 të datës 26.11.2021, Drejtori i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Pejës si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit është liruar nga detyra si drejtor i kësaj drejtorie, mirëpo vlerësimi i rezultateve në punë për

ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej po nga i njëjti, ngase ka qenë obligim i tij ligjor, ndërsa për periudhën nga data 26.11.2021 do duhej të bëhej nga mbikëqyrësi pasues si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit.

Lidhur për faktin se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit tashmë nuk është në pozitë të Drejtorit të Drejtorisë së Administratës, ndërsa sipas ligjit Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej po nga i njëjti konformë nenit 43 paragrafi 5, i cili paragrafë specifikisht parasheh "*Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse*", ngase ka qenë obligim i tij, andaj mbi këtë bazë është konstatuar se vlerësimi është bërë nga organi jo kompetentë dhe se është obligim Ligjor i Kryetarit të Komunës si Zyrtarë kryesor Administrativë që të ndërmerr veprimet me qëllim që të sigurohet që Drejtori i Administratës që ka qenë në cilësi të eprorit të ankuesit të bëjë vlerësimin për periudhën sa ka qenë eprorë i ankuesit, respektivisht eprorët e ankuesit të bëjnë vlerësimet konformë dispozitave të potencuara më lartë .

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.155/2022, datë 07.04.2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Pejës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së,

